

më 7.04.2005 dhe, po atë ditë, i varrosën në Zllakuqan/Zlokuçane.

Burimet: deklarata Z.C, FDH-30716; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Radovan (Aleksa) Stepić

(23.10.1959, serb nga Drenoci/Drenovac, komuna e Klinës/Klina)

Radovani jetonte në fshatin Drenoc/Drenovac. Në datën **11.08.1998**, nga ora 14:30, përderisa me Vladimir Stašić kalonte nëpër *Mëhallën Muhaxheri [Drenoc/Drenovac]*, nga shtëpitë e mëhallës kanë shtënë mbi ta. Radovani ka gjetur vdekjen në vend, ndërkaq Vladimirin e plagosën rëndë. Gjykatësi hetues i Gjyqit të Qarkut e ka kryer hetimin në vendngjarje. Familjarët e kanë varrosur Radovanin në Drenoc/Drenovac.

Burimet: USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 936; Z. Stijović, *Kosmet...*, 117; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.3.3, FDH-30902; *Kosmet gnezdo albanskog terora*, Večernje novosti, 6.11.2003, FDH-32429; *Civilian Victims Of KLA-Victims Of Terrorism In Kosovo And Metohia-1998*-<http://members.fortunecity.com/crnaruka/civ.html>.

Miroslav (Spaso) Klačnja

(27.06.1963, serb nga Beogradi, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miroslavi i kishte mbaruar shkollën e mesme ekonomike dhe trajnimin për polici. Punonte si pjesëtar i policisë rrugore në Beograd. Në verën e vitit 1998, e çuan në Kosovë. Miroslavi e ka humbur jetën më **19.08.1998** në fshatin **Cerrovikë/Cerovik**, përderisa si pjesëtar i patrullës policore po kalonte nëpër fshat. E varrosën në Beograd.

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 938; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 35; M. Sekulić, *Beograd...*, 46; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.3.3, FDH-30902; *Dnevnik od 19. do 25. avgusta*, Ilustrovana politika, avgust 1998, FDH-29547.

Gjon (Lush) Prenaj

(5.06.1922, shqiptar nga fshati Cerrovikë/Cerovik, komuna e Klinës/Klina, punëtor, gjashtë fëmijë)

Para muajit qershor të vitit 1998, Gjoni me familje u detyruan të braktisnin disa herë fshatin Cerrovikë/Cerovik. U kthehin në fshat vetëm kur rreziku nga forcat serbe pushonte. Në fund të muajit qershor të vitit 1998, familja e Gjonit sërish e braktisi fshatin për shkak të sulmit të forcave serbe, por Gjoni kësaj radhe vendosi të rrinte në shtëpi. Pas dy - tri javësh, ai shkoi te familja, e cila gjendej në fshatin Murgë/Murga. Në datën 14.08.1998, Gjoni me bashkëshorten Lezen dhe një grup bashkëfshatarësh të përthyer në moshë u kthyen në **Cerrovikë/Cerovik**, për shkak të shënimit të festës religjioze *Zoja e Berishës*. Pas disa ditësh, në fshat u vra një polic [të shikohet regjistrimi i mëparshëm] dhe, rrjedhimisht, një grup i madh pjesëtarësh të policisë serbe erdhën në fshat. Në shenjë represalie, ata i dogjën shtëpitë e fshatit, në mesin e tyre edhe atë të Gjonit. Nga ajo ditë, Gjoni me Lezen jetonin në oborr. Në datën **24.08.1998**, Gjoni vërejti se pjesëtarë të forcave serbe po punonin diçka me ekskavator në *Mëhallën Bashota*, që ishte afër oborrit të tij. Vendosi të shkonte në katin e dytë të shtëpisë së djegur për të shikuar çfarë po ndodhte. Por, sapo u ngjit shkallëve, e qëlluan me një plumb në kokë. Ka mbetur i vdekur në vend. Ditën tjetër, pjesëtarë të UÇK-së dhe disa komshinj e kanë varrosur Gjonin në kodrën përmbi fshatin e Çabiqit/Çabić. Pas përfundimit të luftës, më 27.06.1999, mbetjet mortore të Gjonit u rivarrosën në varrezat e Cerrovikut/Cerovik.

Burimi: deklarata L.P, FDH-19323.

Nife (Fetah) Merlaku

(25.08.1950, shqiptare nga Gremniku/Grebnik, komuna e Klinës/Klina, njëmbëdhjetë fëmijë)

Nife Merlaku me familje u arratisën nga Gremniku/Grebnik më 13.05.1998. U strehuan në Qupevën e Epërme/Gornje Čupevo, ku i kishte pranuar Isuf Gashi. Aty kanë qëndruar për tre muaj rresht. Në datën **25.08.1998**, forcat serbe e nisën bombardimin e **Qupevës/Čupevo**. Nifja rastisi të ishte te bunari në oborr, kur filluan të binin predha të para. Një predhë ka eksploduar jo shumë larg saj dhe e ka